



MINISTRJA PIRDENI PREZANTON VEPRIMTARINË E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE PËRGJATË 2024

Ministrja e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Adea Pirdeni ishte pjesë e tryezës me përfaqësues të ILDKPKI, OSHC, subjekteve private dhe partnerëve evropianë për të marrë sugjerime rreth projektligjit “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”. Gjatë kësaj tryeze, Ministrja Pirdeni nënvizoi se ky projektligj, pjesë e procesit të përafrimit me BE-në, synon të rrisë integritetin dhe llogaridhënien duke forcuar mbrojtjen e sinjalizuesve dhe duke nxitur raportimin e praktikave të paligjshme.

SHQIPËRIA MË PRANË BASHKIMIT EVROPIAN PAS HAPJES SË TË GJITHË KAPITUJVE TË NEGOCIATAVE

Ministrja e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Zëvendës Kryenegociatore për BE-në, Adea Pirdeni, reagoi pas hapjes së të gjithë kapitujve të negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Evropian. Ajo nënvizon se vendi është më pranë se kurrë familjes së saj natyrale të BE-së, duke theksuar përparimin historik brenda 12 muajsh dhe angazhimin për të mbyllur negociatat dhe anëtarësimin në BE brenda kësaj dekade.



DIALOGU I NIVELIT TË LARTË PËR POLITIKAT NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Në Romë u zhvillua Dialogu i Nivelit të Lartë për Politikat në Ballkanin Perëndimor, i organizuar nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike dhe Ministria Italiane për Administratën Publike. Morëm pjesë në diskutimet mbi forcimin e administratës publike, inovacionin dhe politikat e bazuara në evidenca, në funksion të procesit të integritetit evropian dhe përmbylljes së Programit të Shkëmbimit mbi Kapacitetet Publike me vendet e rajonit.

>>>

PËRMBYLLET TRAJNIMI EKZEKUTIV PËR LIDERSHIPIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Ministrja e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Adea Pirdeni, mori pjesë në ceremoninë përmbylëse të Programit të Trajnimit Ekzekutiv për 83 drejtues të institucioneve qendrore publike. Në fjalën e saj, ajo nënvizoi rëndësinë e forcimit të lidërshiptit dhe ndërtimit të një administrate të fortë dhe të besueshme përballë pasigurisë, një element kyç për anëtarësimin e Shqipërisë në BE. Trajnimi 5-ditor, i zhvilluar në bashkëpunim me Institutin Kombëtar Francez të Shërbimit Publik (INSP), synoi përforcimin e kapaciteteve të drejtuesve dhe vendimmarrjes ligjore në administratën publike, duke kombinuar përvojën evropiane me sfidat e realitetit shqiptar.



BUXHETI 2026, REFLEKTON ZOTIMIN E QEVERISË SHQIPTARE PËR KUSHTE MË TË MIRA PUNE DHE RITJE TË MIRËQËNIES SË PUNONJËSVE DHE FAMILJEVE TË TYRE

Ministrja Pirdeni, prezantoi në seancën plenare projektbuxhetin për vitin 2026. Ajo nënvizoi indeksimin e pagave nga janari 2026 dhe rritjen e pagës minimale në 50,000 lekë, duke siguruar një rritje prej 25% për punonjësit me paga më të ulëta, dhe theksoi se buxheti pasqyron angazhimin për reformën në administratën publike dhe procesin e integritetit të Shqipërisë në BE.sukses të kërkesave të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

